

## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Nga:** Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

**Adresa:** Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9  
Kontakt: [www.ost.al](http://www.ost.al); e-mail: [info@ost.al](mailto:info@ost.al).

**Për:** **OE “H&E ENERGY” sh.p.k.** me **NIPT L71716029A**  
Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati  
“Kosovari”, 1016, Tiranë

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur” me mjete elektronike – Mallra.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Pajisje për mirëmbajtjen e Nënstacioneve”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

**Fondi Limit:** 89,700,000 (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

**Numri i references i procedurës:** REF-83384-12-29-2020

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** Datë 01.02.2021.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike, Nr. 131, Datë 31.12.2020.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 (katër) OE ofertues, me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. **OE “ALEN-CO” sh.p.k.** me **NIPT K83213401M**  
me ofertë ekonomike 84,965,000 (tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH.

2. **OE “H&E ENERGY” sh.p.k.** me **NIPT L71716029A**

me ofertë ekonomike 88,943,000 (tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e dyzet e tre mijë) Lekë pa TVSH.

**3. OE “LIGUS” sh.p.k. me NIPT L51523001S**

me ofertë ekonomike 89,523,000 (tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e tre mijë) Lekë pa TVSH.

**4. OE “ENCOAL” sh.p.k. me NIPT L51531003F**

me ofertë ekonomike 89,652,700 (tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH.

**Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. OE “ALEN-CO” sh.p.k., me NIPT K83213401M, për arsye se:**

- Referuar katalogjeve dhe tabelave, me të dhënat teknike të mallrave të paraqitura nga OE ofertues, në permbushje të pikave 2.3.4 dhe 2.3.5, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, **mallrat: Izolator kalimtare, Radrizator; Relete per mbrojtjen; Komandueset e rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve si dhe Njesia Qendrore e te Dhënave (CPU) per pajisjet e BMT-ve,** te ofruara nga OE ofertues ALEN-CO sh.p.k, nuk permbushin specifikimet teknike te kerkuara nga AK, ne dokumentet e tenderit, konkretisht si me poshte vijon:

**- Izolatore kalimtare;**

Ne specifikimet teknike per Izolatorët kalimtare 220 kV, eshte kerkuar qe Rryma nominale si kerkese minimale te jete 1500 A, ofertuesi lidhur me kete produkt ka ofruar izolatore kalimtar 220 kV te prodhuesit PASSONI & VILLA GRID SOLUTIONS me vlere me te ulet te rrymes nominale 1250 A.

**- Radrizator;**

Ne specifikimet teknike per produktin Radrizatori 400/220V AC/DC eshte kerkuar qe Efiçensa ne ngarkese te plote te jete  $\geq 92\%$ , ndersa ofertuesi ka paraqitur Radrizator 400/220V AC/DC te prodhuesit PMI Elektrik Sistemleri Dis Tic.Ltd. Sti, me Efiçense ne ngarkese te plote  $\geq 90\%$ .

**- Mbrojtja distancionale per daljen e linjës, Mbrojtja Kryesore 1;**

Ne specifikimet teknike per mbrojtjen distancionale per daljen e linjës, Mbrojtja Kryesore 1, Kapaciteti/Overcurrent ne kohen 10 sec, eshte kerkuar 50 XIn, eshte ofruar produkti i prodhuesit NR Electric Co. Ltd, me vlere 30/50 me shtim moduli (Eshtë kërkuar 50 XIn me një modul të vetëm).

**- Releja e kontrollit për daljet e linjës 110 kV dhe seksionimit 110 kV;**

Ne specifikimet teknike per relet e kontrollit për daljet e linjës 110 kV dhe seksionimit 110 kV, Kapaciteti/Overcurrent ne intervalin 10 sec, eshte kerkuar 50 XIn, eshte ofruar produkti i prodhuesit NR Electric Co. Ltd, me vlere 30/50 me shtim moduli (Eshtë kërkuar 50 XIn me një modul të vetëm).

- **Komanduese e rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve;**

Ne specifikimet teknike per produktin e mesiperme lidhur me specifikimet e Ekranit(Display) eshte kerkuar te jete me 15 LED per shfaqjen e funksionimit dhe mesazhet e te cilave 4 LED jane te programueshem lirshem (2x verdhe-ulët, 1x të verdhë/jeshil, 1x të verdhë / të kuq), produkti i ofruar nga ofertuesi, produkt i prodhuesit A. Eberle GmbH & Co. KG, është me 14 LED.

Lidhur me kushtet e ambientit eshte kerkuar qe Temperatura e funksionim te jete  $-25^{\circ}\text{C} \dots +70^{\circ}\text{C}$  eshte ofruar ( $-15^{\circ}\text{C} \dots +60^{\circ}\text{C}$ ); Temperatura e magazinimit eshte kerkuar ( $-40^{\circ}\text{C} \dots +85^{\circ}\text{C}$ ) eshte ofruar ( $-25^{\circ}\text{C} \dots +65^{\circ}\text{C}$ ).

Lidhur me sigurine elektrike nuk disponon asnjërin nga standartet e mëposhtëme:

**IEC 61131-2**, Prova dielektrike me frekuencën e operimit 350 V AC ... 5870 V AC (në varësi të tensionit të operimit të qarkut të energjisë).

**VDE 0435**, Kapaciteti i rrymës me kohë të shkurtër dhe ngarkesa afatgjatë e inputeve të transformatorit te rrymes.  $100 \times I_n / 1s^2 \times I_n$  vazhduar.

Lidhur me përshtateshmeria elektromagnetike nuk ploteson asnjërin nga standartet si vijon: Eshte kerkuar standarti IEC 61000-4-2 Shkarkimi Ekektrostatik (ESD) kV /15 kV, eshte ofruar IEC 61000-6-5 (6 kV/8kV).

Eshte kerkuar standarti IEC 61000-4-3 Fusha Elektromagnetike (HF) 20 V/m 80...3000 MHz eshte ofruar standarti ... 80 ... **2000** MHz

Eshte kerkuar standarti IEC 61000-4-4 Fusha elektrike Kalimtare 6.5 kV, eshte ofruar standarti ... **4kV/2kV**.

- **Njesia Qendrore e te Dhënave (CPU) te paisjeve BMT;**

Ne specifikimet teknike te ketij produkti eshte bere e qarte se kemi te bejme me Njesine Qendrore e te Dhënave (CPU) te paisjes BMT, e sistemit monitorimit On-line te izolatoreve kalimtare dhe shkarkimeve pjesore qe do sherbeje per riparimin e ketij sistemi. Paisja e ofruar nga ofertuesi nuk është CPU por një pajisje monitoruse që pretendohet të plotësohet me sensorët e që ofrohen.

Kjo paisje e ofruar nga ALEN-CO sh.p.k., nga prodhuesi Sparks Instruments SA ne proceduren e prokurimit ka mangesite si vijon:

Eshte kerkuar nga AK ne specifikimet teknike qe paisja lidhur me storage te kete kapacitetin 8 GB ose ekuivalente me madhësinë e të dhënave të regjistruara nga pajisja për një vit, ndersa paisja e ofruar nga OE ofertues nuk ka hapësirë për ruajtje të dhënash të brëndshme por kërkohet prania e një kompjuteri për të bërë ruajtjen e të dhënave të lexuara.

Eshte kerkuar qe mënyra e leximit te jete e vazhdueshme dhe të dhënat të regjistrohen nga pajisja për një vit. Paisja e ofruar lexon në mënyrë të vazhdueshme por këto lexime nuk regjistrohen.

Eshte kerkuar qe trendi i leximit te jete Orare Ditore, Javore, Mujore dhe Vjetore. Paisja e ofruar nuk ka një trend leximi duke qenë qe nuk regjistron të dhëna.

Pajisja e ofruar nga OE ofertues nuk ka te percaktuara parametrat: Temperatura Punës Temperatura e Ruajtjes, Lageshtira gjatë Punës dhe Mbrojtja Depertuese (IP Rating) ndersa ne specifikimet teknike te hartuara nga AK jane percaktuar keto parametra si vijon: Temperatura Punës eshte kerkuar -40 – +50 °C; Temperatura e Ruajtjes eshte kerkuar -50 - +85 °C; Lageshtira gjatë Punës eshte kerkuar 5 -95 % RH si dhe Mbrojtja Depertuese (IP Rating) eshte kerkuar IP55.

Ne specifikimet teknike kerkohet qe Protokollet e Komunikimit te jene Mod Bus, DNP3, IEC61850. Paisja e ofruar nga OE ofertues lidhur me protokollet e komunikimit disponon ModBus dht tdb pra i mungojne protokollet DNP3 dhe IEC61850.

Menyrat e komunikimit te paisjes ne specifikimet teknike jane percaktuar USB, RS232, RS485, Ethernet dhe 3G, ndersa paisja e ofruar nga OE ofertues ka vetëm portën RS485 dhe Ethernet pra mungojnë portat e tjera.

Gjithashtu lidhur me SOFTWARE-in e paisjes se ofruar nga OE ofertues ka keto mangesi:

- i. Pajisja nuk mat Temperaturën e vajit dhe lagështirën e ambientit sipas kërkesës së specifikimeve teknike.
- ii. Lidhur me leximet javore për Shkarkimet e Pjesshme Persistenca nuk realizohet duke qenë që pajisja bën vetëm matje në kohë reale.
- iii. Pajisja nuk gjeneron trekëndëshat e PD dhe Kapacitancës.
- iv. Nuk përcaktohet nëse ka WUI Web User Interace që të bëhet i mundur leximi i të dhënave në mënyrë lokale dhe në rrjet.

**Si rezultat i pershkrimit te mesiperm paisja nuk ploteson specifikimet teknik dhe nuk eshte funksionale lidhur me sherbimin qe do te kryeje.**

**2. OE “LIGUS” sh.p.k., me NIPT L51523001S, për arsye se:**

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar per pajisjet sekondare: komanduese te rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka paqitur katalog të përkthyer në gjuhën shqipe për pjesën që i përket të dhënave teknike per pajisjet: Izolatore kalimtare 400 kV, Izolatore kalimtare 220 kV dhe Komanduese te rregullatorit automatik te tensionit te autotransformatoreve. Ka paraqitur vetem skeden me vizatimet e izolatoreve dhe ato te pa perkthyer ne gjuhen Shqipe.

- Referuar tabelave me të dhënat teknike të mallrave të paraqitura nga OE ofertues, në përmbushje të pikës 2.3.5, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit, lidhur me mbrojtjen rele, ofruara nga OE ofertues **LIGUS sh.p.k.**, nuk përmbush specifikimet teknike të kerkuara nga AK në dokumentet e tenderit, konkretisht si me poshte vijon:
  - Lidhur me relete në specifikimet teknike është kërkuar që fuqia e punës në tensionin nominal V DC të jete 1000 W është ofruar nga OE ofertues 570 W.
  - Në çkycje fuqia e kërkuar në tensionin nominal VDC është kërkuar 1000 W, është ofruar nga ofertuesi 570mW.
  - Lidhur me mbrojtjen distancionale për daljen e linjës, Mbrojtja Kryesore 1, Instrumenta tregues dhe matës, konsumi i energjise është kërkuar  $\leq 20$  VA është ofruar nga ofertuesi 50 VA
  - Lidhur me relene e kontrollit për daljet e linjës 110 kV dhe seksionimit 110 kV, është kërkuar që tensioni i kontrollit për qarqet njohje/rikthim (nga ushqimi i brendshëm) të jete  $48 + 20 \% V DC$ , ndërsa OE ofertues nuk ka paraqitur asnjë vlerë.
  - Lidhur me portat e komunikimit serial është kërkuar Protokoll: SPA bus; Ethernet është ofruar vetëm Ethernet. Është kërkuar Interface RS 485 USB, është ofruar vetëm RS 485.
- 3. OE “ENCOAL” sh.p.k., me NIPT L51531003F, për arsye se:**
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për asnjë nga mallrat e paraqitur në shtojën 1, Formulari i ofertes.
  - Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse nuk ka paraqitur katalog të përkthyer në gjuhën shqipe për pjesën që i përket të dhënave teknike për mallrat e kerkuara në shtojcën 1, Formulari i ofertes.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë e **OE “H&E ENERGY” sh.p.k.**, me **NIPT L71716029A**, Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati “Kosovari”, 1016, Tiranë, për vlerën 88,943,000 (tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e dyzet e tre mijë) Lekë pa TVSH, se është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15.02.2021.

Ankesa: Jo.

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**

**Skerdi Drenova**